

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse dy ish-politikanë austriakë të përfolur për korrupsion vrapojnë pas autokratit serb?
ADRESA	https://piranjat.al/bota/pse-dy-ish-politikane-austriake-te-perfolur-per-korrupsion-vrap-ojne-pas-aut-i104071
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:32:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:23:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cff8fdb3103632fb0b90f1d32b46d9d51cd561161cd5a09f87b81a9e759b2fc4
TEKSTI	3fdb26369c088e0c44360f812c07b0e02ed372ddec3ca88de569ec465f65460a
PAMJA	b54ab758dc56bc69771c9923d12a342cf48cc160b0d4c3b6b80487e28bf28ac3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	069a813e5752aca6e28266756231914d74bed75a906d3b617a0f3b4a4bc4ceb6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/069a813e5752aca6e28266756231914d74bed75a906d3b617a0f3b4a4bc4ceb6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [te macronit](#) ■ [fëmijë, shkolla](#) ■ [Këtë 14 shtator dyert e shkollës](#) ■ [shkollë e](#) ■ [dyert këtë shtator në](#) ■ [NUK ka pasur loitar](#) ■ [ka dyert heshtjen në një intervistë](#) ■ [Koçeku: politike nga subiekte](#) ■ [pezu detyra efektiv](#)

[BOTA](#)

Pse dy ish-politikanë austriakë të përfolur për korrupsion vrapojnë pas autokratit serb?

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 18:23



Para se të varroset kriminelin i luftës Ratko Mlladiq, në Serbi qëndruan dy politikanë austriakë: Johannes Hahn, kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Bankës Kombëtare të Austrisë, dhe ish-kancelari Sebastian Kurz, i dorëhequr pas akuzave për korrupsion.

Të dy e takuan autokratin serb Aleksandar Vučić në një drekë të Sombor, një qytet në Vojvodinë, i njohur për specat e famshëm e të quajtur somborka, të cilët prej dekadash lënë gjurmë në pothuaj çdo kuzhinë ballkanike dhe me shtrirje gjithnjë e më të madhe edhe në Evropë. Vështirë të mendohet se politikanët austriakë shkuan në Sombor për të blerë specia somborka për turshi.

Vetë Vučići publikoi një fotografi me «miqtë nga Austria dhe Gjermania» (kishte edhe biznesmenë gjermanë në takim). Momenti i vizitës së politikanëve austriakë është interesant: ata shkuan në Serbi para se të varroset Mlladiqi (me nderime shtetërore dhe ushtarake) dhe para se të shpallëshin zgjedhjet parlamentare të parakohshme.

Ndonëse Hahn tha se bëhej fjalë për vizitë «private», Partia e Gjelbër në Austri ka kërkuar shpjegime për këtë vizitë me gostitje në Serbi.

Nuk duhet harruar: Hahn ka qenë edhe komisioner i BE-së për zgjerim. Në takimin e zhvilluar në Sombor të Vojvodinës ishte i pranishëm edhe Siegfried Wolf, ish-menaxher i kompanisë Magna, i cili është një lloj oligarku austriak, «me lidhje të shkëlqyera në Moskë», siç njofton revista «profil» e Vjenës.

Banka Kombëtare e Austrisë njoftoi se bëhej fjalë për vizitë private, «që nuk ka absolutisht asnjë lidhje me funksionin e tij si kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Bankës Kombëtare të Austrisë». Revista «profil» pyet me ironi nëse koha e takimit – pak para zgjedhjeve dhe pikërisht kur Vučić po përpiqet të bëhet sërish në kryeministër – ishte thjesht rastësi. Trumcakët mund të besojnë se ishte rastësi.

Shumë politikanë austriakë nuk ngurrojnë t'u shërbejnë figurave të dyshimta politike nëpër botë. Karin Kneissl, ish-ministre e Jashtme (2017-2019), vallëzoi me Vladimir Putinin në dasmën e saj më 2018, më vonë u bë anëtare e bordit të gjigandit rus Rosneft, dhe në vitin 2023 u shpërngul përfundimisht në Shën Petersburg, ku sot drejton një think-tank gjeopolitik pranë universitetit vendas.

Alfred Gusenbauer, ish-kancelar social-demokrat (SPÖ, 2007-2008), ishte i lidhur me DOC Research Institute, themeluar nga Vladimir Jakunin, ish-shefi i Hekurudhave Ruse dhe besnik i afërt i Putinit. Gusenbauer u përfshi gjithashtu në lobim të paguar për regjimin pro-rus të ish-presidentit ukrainas Viktor Janukoviç. (Gusenbauer e ka demantuar këtë, kush dëshiron mund t'i besojë).

Wolfgang Schüssel, ish-kancelar i konservatorëve (ÖVP), hyri në bordin e kompanisë ruse Lukoil, dhe më parë kishte lidhje edhe me kompaninë ruse të telekomunikacionit MTS.

Christian Kern, ish-kancelar socialdemokrat dhe ish-drejtor i Hekurudhave Austriake, u bë anëtar i bordit mbikëqyrës të Hekurudhave Shtetërore Ruse (RZD).

Tre ish-kryeministër të Austrisë kanë mbajtur poste fitimprurëse në organizata të afërta me Kremlinin – kjo është e paprecedent në Europë. Dhe nuk mbaron me kaq.

Hans Jörg Schelling, ish-ministër i Financave (ÖVP), pas largimit nga qeveria u bë këshilltar i kompanisë gjigande ruse të gazit Gazprom, në lidhje me gazsjellësin Nord Stream 2.

Në vitin 2016 krerët e partisë së djathtë FPÖ shkuan në Moskë për të nënshkruar një marrëveshje miqësie me partinë e Vladimir Putinin, pastaj postuan në rrjetet sociale fotografi nga Sheshi i Kuq i Moskës. Kjo parti mban lidhje të ngushta edhe me politikanë nacionalistë në Serbi dhe në pjesën e Bosnjës të kontrolluar nga serbët.

Pasi Putini pushtoi Krimenë ukrainase më 2014, Austria ishte vendi i parë në Europë që agresorit rus ia shtroi qilimin e kuq. Atëbotë kancelar ishte një socialdemokrat. Katër vite më vonë, më 2018, Putini prapë u mirëprit në Vjenë, kësaj radhe kancelar ishte një politikan konservator. Putini vazhdoi të ishte agresor, luftën e kishte zgjeruar edhe në pjesën lindore të Ukrainës.

Afërsia e politikanëve austriakë me Putinin ka traditë. Në fillim të mandatit si president i Rusisë ai u fotografua duke zbritur në pistën e skive në qendrën dimërore të sporteve, St. Anton. Pranë tij rrëshqiste kancelari i atëhershëm Wolfgang Schüssel.

Në vitin 2019 shefi i shërbimit sekret austriak u ankua se Austria nuk po trajtohej si partner i barabartë në të ashtuquajturin Klub i Bernës, i cili përbëhet nga drejtuesit e shërbimeve të inteligjencës të 28 vendeve të BE-së, si edhe të Norvegjisë dhe Zvicrës. Europeanët e tjerë nuk donin të ndanin informata me austriakët për shkak të afërsisë së politikanëve të Vjenës me Rusinë.

Në vitin 2026 disa politikanë austriakë mbase nuk marrin guximin të shkojnë në Moskë për shkak të reagimeve të BE-së, por në Sombor të Serbisë ngarendin pa problem.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 14 Shtator18:12

Nga Amsterdam e Venecia deri te Miami/ 10 qytetet që rrezikojnë të zhduken deri në vitin 2050

Mbi 570 qytete bregdetare dhe 800 milionë banorë janë në rrezik për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe fundosjes s...

BOTA 14 Shtator18:06

Takimi më rrjetet sociale kthehet në 'ferr' për 22-vjeçaren. I riu e fut në bodrum dhe e abuz*n për orë të tëra

Ai dyshohet se e rrëmbëu për disa orë në një bodrum dhe e detyroi të përjetonte dhunë fizike dhe akte seksuale të p...

BOTA 14 Shtator17:40

Takimi në Tinder që alarmoi NATO-n, oficeri spanjoll nën hetim pas lidhjes me një grua të lindur në ish-Bashkimin Sovjetik

Një njohje përmes aplikacionit të takimeve Tinder është kthyer në një çështje sigurie për NATO-n, pasi nj&...

BOTA 14 Shtator16:18

"Ai do të ishte krenar"/ Kryeministri britanik humb babain që vuante nga Alzheimeri

Kryeministri britanik Andy Burnham është në zi pas vdekjes së babait të tij, Roy Burnham, i cili vuante prej vitesh nga sëmundja e...

BOTA 14 Shtator16:06

Finlanda do t'i bashkohet mbrojtjes bërthamore të Macronit

Finlanda ka vendosur t'i " bashkohet" armës parandaluese bërthamore "të përparuar&rd...

Piranjat News BOTA 14 Shtator11:37

Ku përfundojnë makinat e vjedhura në Greqi?

Një makinë zhduket nga një rrugë e Athinës brenda pak minutash. Pronari njofton policinë, raporton vjedhjen dhe pret. Pyetja the...

BOTA 14 Shtator10:51

Kallas për sulmin rus ndaj trenit pranë Polonisë: Qëllimi është të trembë vendet që mbështesin Ukrainën

Sulmi i djeshëm me dron rus ndaj një treni në kufirin e Ukrainës me Poloninë, anëtare të NATO-s, kishte për qëlli...

BOTA 14 Shtator10:30

Deputetët britanikë kërkojnë një ligj të ri për të adresuar kërcënimin e IA-së ndaj të drejtave të njeriut

Një grup deputetësh dhe kolegësh nga shumë parti në Britani po kërkojnë një ligj të ri për të adresuar ...

BOTA 14 Shtator10:00

Trump: Do të shqyrtoj kërkesën e familjeve të viktimave për publikimin e të dhënave të 11 shtatorit

Presidenti amerikan, Donald Trump tha të dielën se do të shqyrtojë kërkesat e familjeve të viktimave të 11 shtatorit pë...

BOTA 14 Shtator09:32

Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Rumani

Për ukrainasit, lufta ajrore e Rusisë është prej vitesh një realitet i përgjakshëm dhe i hidhur. Nga raketat, bom...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...](#)


Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos. Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!





Reagon Clevio!




Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Deklarata e Gjedit!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.